04

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INTEGRIMIT, POLITIKAVE SOCIALE DHE INFORMIMIT
SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, PROMOVIMIT, RINISË DHE TURIZMIT

Nr 11044 *prot* *Datë* 15 / 12 /2025

RELACION
PËR NË KËSHILLIN BASHKIAK

PËR NJË SHTESË NË VKB –NË NR 108 DATË 21.11.2025 : "MBI MIRATIMIN E BURSAVE TË SHTETIT PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PROFESIONAL PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN MËSIMOR 2025-2026"

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Këshilltar!

Pranë Bashkisë Lushnje është paraqitur një kërkesë për plotësim dokumentacioni për përfitimin e busave të shtetit për nxënësit e arsimit profesional parauniversitar me nr prot 10 918 date 10.12.2025 për binjakët : Fabian dhe Biorni Bitri.

Në zbatim të VKM-së nr. 666 datë 10.10.2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", i ndryshuar, për vitin shkollor 2025-2026", si dhe në vijim të verifikimeve të kryera në Njesinë Administrative Kolonjë, ju parashtrojmë për shqyrtim rastin e dy binjakëve Fabian dhe Biorni Bitri , të cilët më herët kanë përfituar ndihmë ekonomike si pjesë e skemës së ndihmës ekonomike (trinjake , së bashku me motrën), dhe pas mbushjes së moshës madhore 18 vjeç , kjo ndihmë iu ndërpre.

Pas rivlerësimit të situatës ekonomike të familjes, u konstatua se:

- Familja aktualisht plotëson të gjitha kriteret ligjore për përfitimin e ndihmës ekonomike sipas legjislacionit në fuqi;
- Të ardhurat familjare janë nën nivelin e përcaktuar për përfitim;

Për sa më sipër dhe sipas dokumentacionit të depozituar, familja Bitri trajtohet me ndihmëekonomike .

Në mbështetje të familjeve në nevojë dhe në përputhje me VKM- ne 666 date 10.10.2019 2019 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", i ndryshuar , *propozojmë , miratimin e këtij rasti nga Këshilli Bashkiak.*

Faleminderit për mirëkuptimin!

Sektori i Zhvillimit Ekonomik, Promovimit, Rinisë dhe Turizmit

Blerina Mebelli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr 11044/1 *prot* *Datë* 15 / 12 /2025

PROJEKT VENDIM

NR. 109 *DATË* 15 / 12 /2025

PËR NJË SHTESË NË VKB –NË NR 108 DATË 21.11.2025 : "MBI MIRATIMIN E BURSAVE TË SHTETIT PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PROFESIONAL PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN MËSIMOR 2025-2026"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___/___/ 2025 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë***: Për një shtesë në VKB –në nr 108 datë 21.11.2025 : " Mbi miratimin e bursave të shtetit për nxënësit e arsimit profesional parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin mësimor 2025-2026".***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 19 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, te gërmës b, të pikës 1, të nenit 9, të nenit 30, të gërmës n, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore" të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidëve të punës", të ndryshuar,të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", si dhe të pikes 4,5,8 ,9 dhe 14 të VKM-së nr 666 datë 10.10.2019 " Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar , si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të vecanta në institucionet arsimore parauniversitare publike" , Këshilli Bashkiak Lushnje:

PROPOZON:

***I*)T'u jepet bursë nxënësve :**

SHKOLLA "MEKANIKE BUJQËSORE HASAN D.GINA"LUSHNJE

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Dega	Klasa	Kriteri	Lloji i bursës
1	Fabian Armand Bitri	SHMT	XII	Ndihmë ekonomike	Bursë e plotë
2	Biorni Armand Bitri	TIK	XII	Ndihmë ekonomike	Bursë e plotë

II -Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit, Sektori i Zhvillimit Ekonomik, Promovimit, Rinisë dhe Turizmit .

III- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

Sektori i Zhvillimit Ekonomik ,Promovimit,Rinisë dhe Turizmit

Blerina Mebelli

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE